



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVO

KOMUNA E KLINËS
MUNICIPALITY OF KLINA
OPŠTINA KLINA



www.komuna-kline.org

Duke u mbështetur në nenin 43 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Nr. 03/L-040, nenit 47 të Statutit të Komunës dhe nenit 4 të Rregullores për Punë të Kuvendit dhe Komiteteve të Komunës, Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, bën këtë:

N J O F T I M

Njoftohen të gjithë anëtarët e Kuvendit të Komunës së Klinës, që të marrin pjesë në seancën e IV-të të punës për vitin 2015, që do të mbahet më 24.04.2015, në sallën e Kuvendit të Komunës së Klinës, duke filluar me punë në orën 10:00.

Kërkohet nga anëtarët e Kuvendit që të marrin pjesë në seancë, ndërsa në rast të mungesës eventuale - mungesa duhet të arsyetohet me shkrim para mbajtjes së mbledhjes.

Lidhur me çështjen e mospjesëmarrjes në seancë, t'i referoheni dispozitës së nenit 39 të LVL-së.

Lidhur me këtë seancë propozohet ky:

R E N D I I D I T Ë S

1. Arsyetimi i mungesave,
2. Shqyrtimi dhe miratimi i dy procesverbaleve të seancave të kaluara,
3. Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit financiar të Komunës për periudhën janar-mars 2015,
4. Shqyrtimi dhe miratimi i Propozimit të Kryetarit për vënien në diskutim publik të dy Projekt-rregulloreve:
 - a. Projekt-rregullore për subvencione dhe transfere, dhe
 - b. Projekt-rregullore për simbolet, ndarjen e titujve të nderit dhe shpërblimet tjera,
5. Shqyrtimi dhe miratimi i Propozimit për plotësimin e vendit vakant me anëtar të ri nga subjekti i AAK në vend të Agron Bacaj, në Komisionin për vlerësimin e ofertave për dhënie në shfrytëzim të pronës komunale,
6. Shqyrtimi dhe miratimi i zëvendësimit me një anëtar të ri nga komuniteti ashkali në vend të Gani Vrankaj, në Komitetin për Komunitete,
7. Raportimi:
 - I Drejtorit të Shëndetësisë për gjendjen në shëndetësi në Komunën e Klinës, si dhe
 - I Drejtorit të QKMF-së për gjendjen në po këtë Qendër Shëndetësore,
8. Të ndryshme.

01Nr. 06-2842/2015
Klinë, më 15/04/2015



KRYESUESI,
Dr. Haxhi Ibishi